




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të Ligjit nr.2008/03 L040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit 03/L-090 për Partneritet Publiko Privat, bazuar në Marrëveshjen për Pilot-projektin në Lagjen "Dardania", Kërkesës së Komisionit Komunal të Aksionarëve Gjilan, Vendimit të Kuvendit Komunal të datës 25.11.2010 për formimin e Komisionit për vlerësimin e aseteve të KRM Higjiena Gjilan, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 29.03.2011 miratoi këtë:

VENDIM

Për dhënien e pëlqimit për themelimin e partneritetit publiko-privat në ofrimin e shërbimeve për trajtimin e mbeturinave

I

Përmes këtij vendimi me qëllim të investimeve në KRM Higjiena Gjilan fillojnë procedurat për themelimin e partneritetit publiko-privat në ofrimin e shërbimeve për trajtimin e mbeturinave sipas ligjit të PPP, për realizimin e investimeve të reja sipas projektit për modernizimin e grumbullimit, transportimit, separimit të mbeturinave dhe të kalohet në sistemin e trajtimit sipas standardeve të BE, deri në riciklim të mbeturinave.

II

Partneriteti Publiko-Privat nuk nënkupton shitje ose privatizim të aseteve apo aksioneve të KRM Higjiena Gjilan, por që përmes marrëveshjes dhe kontratës mes KK Gjilan dhe Partnerit Privat me kohëzgjatje sipas ligjit dhe negociatave finale, menaxhimin e kompanisë do t'a bëjë Investitori dhe përqindja e biznesit të cilat do t'i mbaj KRM Higjiena do të jetë jo më shumë se 49 përqind. Të punësuarit aktual janë obligim i investitorit t'i mbajë në punë, konform Ligjit dhe rregullave të punës, përveç që mund të bëhet ristrukturimi dhe risistematizimi i tyre.

III

Realizimi i këtij projekti do të bëhet në pajtueshmëri të plotë me ligjet të lartëcekura, duke i respektuar të gjitha procedurat deri në nënshkrimin e kontratës mes KK Gjilan dhe Investitorit, i cili do të realizoj planin investiv të propozuar nga Komuna e Gjilanit.

IV

Përmes këtij vendimi autorizohet komisioni i formuar nga KK Gjilan për vlerësimin e aseteve të KRM Higjiena, që në bashkëpunim me zyrën e investimeve PPP dhe me zyrën e prokurimit, pas përpilimit të kriterëve, të shpallin ftesën për ofertim të hapur, të bëjnë vlerësimin e ofertave, përzgjedhjen e ofertuesit, zhvillimin e negociatave finale dhe t'i raportojnë Kuvendit Komunal për të gjitha aktivitetet deri para nënshkrimit të kontratës me investitorin.

V

Zbatimin dhe monitorimin e këtij vendimi e bënë KK Gjilan përmes komisionit të formuar, ndërsa për implementimin e tij kujdeset kryetari i Komunës së Gjilanit,

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.